



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:075267
Datë: 17.10.2024
Numri i dokumentit: 06315064

C.nr.366/24

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Blerina KURTAJ me bashkëpunëtoren profesionale Gresa Haxhiavdyli, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses N.D. nga Gjakova, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj avokat në Prishtinë, Rr. “Fehmi Agani” Hy-25/4 Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 833.00 euro, jashtë seance me datë 17 tetor 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses N.D. nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses të lartcekur në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 10% të pagës bazë për 25 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 24.01.2021 deri me datë 06.02.2023, të ia paguajë shumën prej 425.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 24.01.2024 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditëses mbi shumën e aprovuar sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në shumën prej 408.00 euro.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës paditësit t'ia paguaj shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja në këtë gjykatë me datë 24.01.2024, përmes të autorizuarit të saj ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, duke theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune me të paditurën. Ka kërkuar që në emër të kualifikimit nga data 01.01.2019 deri me datë 06.02.2023 të i paguhet shuma në emër të kualifikimit arsimor, ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 23.05.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se nga provat e prezantuara – listat e pagave të paditësit shihet se sa i përket shtesave nga e paditura mbi bazën e kualifikimit, të njëjtat përmbushen çdo muaj. Kërkesës së paditëses i mungon baza pasi që kjo e drejtë nuk i takon me Ligjin e Punës numër 03/L-212 i cili rregullon kontestet e punës. Sa i përket Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33 i datës 29.08.2008, në asnjë pikë të tij nuk ekziston ndonjë detyrim të cilin Komuna e Gjakovës duhet ta përmbushë. Edhe nëse do të kishte, Qeveria nuk e ka mbështetur të paditurën me mjete financiare për ta përmbushur detyrimin e pretenduar. Periudha e kërkuar është e pamundur të realizohet pasi që nuk prodhojnë asnjë efekt juridik kontratat të cilat janë shkëputur me datë 21.11.2022. Tutje ka konsideruar se në rastin konkret kërkesëpadija e paditëses është parashkruar në tërësi, e po ashtu i njëjti as nuk i ka shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Po ashtu ka shtuar se bazuar në praktikën e deritanishme nga të gjitha instancat e Republikës së Kosovës, kompensimet e tilla kanë karakter deklarativ e jo detyrues, kjo për shkak se lihet në diskrecion të palëve kontraktuese të gjendet mundësia financiare. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së,

gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësin, e lëshuar nga Komuna e Gjakovës–Drejtoria Komunale e Arsimit, këtu e paditura, paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në IP “Ganimete Terbeshi” në Gjakovë, si edukatore. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës 01.11.2022-30.11.2022 vërtetohet fakti se paditësja realizon pagë bazë në lartësi prej 349.05 euro (koeficienti 5.5) dhe në emër të kualifikimit për çdo muaj për këtë periudhë i është paguar shuma prej 17.90 euro. Paditësja ka përfunduar nivelin e studimeve mbi shkallën e përgatitjes profesionale (shkolla e mesme) më me datë 28.05.1983 dhe ka marrë titullin motër e Pediatrisë, fakt i vërtetuar përmes Diplomës së lëshuar nga shkolla “Hysni Zajmi” me numer 40/259. Gjkata konform nenit 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Gjkata gjen se në rastin në fjalë zbatohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008, vendim i cili ka qenë në fuqi deri me datë 31.01.2023, ku është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik numër 08/L-196. Sipas këtij vendimi, në pikën 1 është përcaktuar se *“Që nga data 01.09.2008 të gjithë mësimmësuesit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*, ndërsa pika 4 nën-pika 1 e tij, ka përcaktuar se *“Me diplomë të Shkollës së Mesme përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%”*. Pasi që nga provat e lartcekura u vërtetua se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, se i njëjti ka diplomë me titull bachelor rezulton se konform vendimit të lartcekur, paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, më konkretisht të pjesës së pa kompensuar lidhur me këtë të drejtë monetare për çdo muaj për periudhën kohore nga data 24.01.2021 deri me datë 06.02.2023 apo për 25 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditëses i takon diferenca në shumë të përgjithshme prej 425.00 euro, për këtë kriter të kompensimit.

Duke qenë se kjo gjendje faktike nuk është kontestuese në mes të palëve, pasi që e paditura në asnjë formë nuk e ka kontestuar faktin se paditësi është i punësuar tek e paditura dhe se në periudhën prej datës 24.01.2021 deri me datë 06.02.2023 apo për 25 muaj të njëjtës nuk i është kompensuar pjesa tjetër e shtesave në emër të kualifikimit shuma prej 17.00 euro, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadiisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për kualifikim, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadiisë rrjedh nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës në tërësi, ky pretendim rezulton të jetë i pabazuar sa i përket periudhës kohore nga data 24.01.2021 deri me datë 06.02.2023, pasi që bazuar në nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 24.01.2024, rezulton se për periudhën e lartcekur, padia është paraqitur brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Ndërsa sa i përket pretendimit lidhur me mungesën e buxhetit, edhe ky pretendim është i pabazuar dhe nuk gjen mbështetje në asnjë normë ligjore të aplikueshme, e për më tepër gjykata e vlerëson si të parëndësishme për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestuese, pasi që paditësi nuk është përgjegjëse për planifikimin e buxhetit për obligimet që dalin nga Vendimi numër 01/33, andaj edhe rrethanat subjektive të të paditurës lidhur me mos planifikimin me kohë të buxhetit për zbatimin e vendimit të lartcekur nuk e liron të njëjtën nga detyrimi për pagesën e këtyre shpenzimeve.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Sa i përket pjesës refuzuese gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që pretendimet e përfaqësueses ligjore të të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, gjykata i morri pjesërisht si të bazuara dhe atë vetëm sa i përket periudhës kohore prej datës 01.01.2019 deri me datë 23.01.2021, pasi që nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se paditësja kërkesën e saj për kompensimin në emër të kualifikimit për periudhën e lartcekur e ka parashtruar pas afatit kohor prej 3 (tre) viteve siç parasheh neni 87 i Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, andaj në rastin konkret padia për këtë periudhë kohore është parashtruar me datë 24.01.2024 që nënkupton më shumë se tri vite nga lindja e të drejtës për kërkesën nga marrëdhënia e punës, përkatësisht lidhur me kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për çka gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori sipas nenit 449 dhe 452 par.1 të LPK-së, me ç’rast paditësit iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 124.00 euro. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00 euro (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104.00 euro, (e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.366/24, më 17 tetor 2024

Gj y q t a r j a

Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimi të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.